



29-09-2023

02-320/03-1187

	<b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika Kosova-Republic of Kosovo</b>	
	<b>Komuna e Vitisë</b> <b>Opstina Vitina-Municipality of Vitina</b>	

ZYRA E PROKURIMIT

KONTRATË PËR PUNË

Nr <sup>1</sup> i prokurimit	657-23-6765-5-1-1
Nr i brendshëm	VI657-23-035-511

Titulli i kontratës : GRANTI PERFORMANCËS 2023,  
LOT II: Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kallderm rreth lumit  
Moravë Viti.

E LIDHUR NË MES TË

Operatori ekonomik	Autoriteti kontraktues
Grup i Operatorëve Ekonomik: KUSHTRIMI NM SH.P.K.; " Burimi - E " Sh.p.k., Viti, -	Komuna e Vitisë
Përfaqësuar nga:	Përfaqësuar nga:
Kushtrim Misini, me autorizim	Fadil ABAZI, përgjegjës i prokurimit
	

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me kërë aktivitet të prokurimit

Titulli: GRANTI PERFORMANCËS 2023 LOT II: Rregullimi i rrugës e he trotuarit me kallderm rreth lumit Moravë Viti: VI657-23-6765-5-1-1;  
Nr.b.VII 57-23-035-511

**PJESA B: KONTRATA & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA**

**PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA**

*Komuna e Vitisë, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë; dhe*

*Grup i Operatorëve Ekonomik: KUSHTRIMI NM SH.P.K.; " Burimi - E " Sh.p.k., Viti, në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:*  
**GRANTI PERFORMANCËS 2023 LOT II Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kallderm rreth lumit Moravë**  
Viti.numër identifikues: 657-23-6765-5-1-1

**Neni 1 Lënda**

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: GRANTI PERFORMANCËS 2023 LOT II Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kallderm rreth lumit Moravë Viti.
- 1.2 Fillimi i realizimit të kontratës: Kontraktori duhet të jetë i gatshëm për fillimin e punëve menjëherë gjegjësisht kur të merr urdhër për fillimin e punëve nga Autoriteti Kontraktues.

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **277,777.50 €**

Me fjalë: Dyqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë, e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë Euro/50 Centi

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Kjo kontratë është dy vjeçar pagesat do të bëhen sipas situacioneve të punëve të kryera, pasi buxheti mundëson përfundimin e kelij projekti.

2.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

**Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (f) (Procesverbali i mbledhjes informativë/vizitës së vendit)
- (g) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në rast të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

**Neni 4 Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të

Titulli: GRANTI PERFORMANCËS 2023 LOT II: Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kallderm rreth lumit Moravë Viti; VI657-23-6765-5-1-1;  
Nr.6.VII 57-23.035-511

kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën [shqipë]² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Kontraktuesin:		Për Autoritetin Kontraktues:	
Emri:	Kushtim Misini	Emri:	Fadil ABAZI
Pozita:	Me autorizim	Pozita:	Përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	29.05.2023	Data:	28.09.2023
Vula:		Vula:	

Zyrtari Kryesor Financiar

Emri:	Sokol HALITI
Pozita:	Kryetari i Komunës
Nënshkrimi:	
Data:	29.05.2023
Vula:	

## PJESA II E KONTRATES KUSHTET E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grup i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Titulli: GRANTI PERFORMANCËS 2023 LOT II: Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kallderm rreth lumit Moravë Viti: VI657-23-6765-5-1-1;  
Nr. b.VI(57-23-035-511

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruara dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## **Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm**

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërrnjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## **Neni 3 Transferimi**

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshlatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

## **Neni 4 Nën-kontraktimi**

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë.

4.2 Kontraktuesi nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Menaxheri i Projektit. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Menaxherit të Projektit. Menaxheri i Projektit do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeht lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e lirion Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti

Titulli: GRANTI PERFORMANCES 2023 LOT II: Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kallderm rreth lumit Moravë Viti: V1657-23-6765-5-1-1;  
Nr.b.VII/57-23-035-511

kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

#### **Neni 5 Personeli**

5.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

#### **Neni 6 Obligimet e Kontraktuesit**

6.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrat. Ekzekutimi i urdhrat administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

6.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

6.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

6.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

6.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 8.

6.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

6.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

6.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përroth, trafikun etj.

6.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteve në vend punim.

#### **Neni 7 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit**

7.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

7.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;

Titulli: GRANTI PERFORMANCËS 2023 LOT II; Rregulimi i rrugës dhe trotuarit me kallderm rreth lumit Moravë Viti: VI657-23-6765-5-1-1;  
Nr.b.VII 57-23-Q35-511

- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

7.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

7.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

7.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrisë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

## **Neni 8 Programi**

8.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

8.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnojë Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

8.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

8.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rrisë detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

## **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti Kontraktues do të emërojë "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

9.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.

9.3 Kohën dhe vendin për testim do ta caktojë Menaxheri i Projektit.

9.4 Koston e testimit si dhe çdo gjë tjetër në lidhje me testimin do të sigurojë kontraktuesi, në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.

9.5 Në qoftë se Menaxheri i Projektit ose kontraktuesi nuk pajtohen me rezultatet e testimit, mund të caktojnë kohën dhe vendin për ri-testim. Koston e ri-testimit e siguron pala e cila ka gabuar në rezultatet e testimit. Në qoftë se pas testimit, Menaxheri i Projektit konstaton se cilësia e materialeve nuk është e cilësisë së materialeve të specifikuara, ka të drejtë të kërkojë nga kontraktuesi ndërrimin e materialit pa ndryshuar çmimin kontraktues.

## **Neni 10 Fillimi i punëve**

10.1 Kontraktuesi do të fillojë punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

10.2 Kontraktuesi do të ndërtojë dhe instalojë Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përjetësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësojë ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

## **Neni 11 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit**

11.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye.

a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës.

b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 10;

11.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

11.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 11.2 Autoriteti Kontraktues do t'i lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

## **Neni 12 Paralajmërim i hershëm**

12.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vonë në kualitetin e punëve.

12.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitohet menjëherë dhe do t'i konsiderojë pasojat.

12.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet në stanciale të punëve janë bere të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

## **Neni 13 Korrigjimi i defekteve**

13.1 Menaxheri i Projektit do të njoftojë Kontraktuesin mbi ndonjë defekt para përfundimit të periudhës garantuese të defekteve, e cila fillon në Përfundim. Kohëzgjatja e periudhës garantuese të defekteve është përcaktuar në KVK. Periudhës garantuese e defekteve do të zgjatet deri sa të përmirësohen defektet.

13.2 Çdo here që epet njoftim mbi Defektet, Kontraktuesi do t'i korrigjojë defektet brenda afatit kohor të specifikuar në njoftimin e Menaxherit të Projektit.

13.3 Kontraktuesi do t'i eliminojë defektet dhe do të arrijë cilësinë e duhur të punës brenda kohës së caktuar nga Menaxheri i Projektit dhe kjo do të arrihet pa ndryshimin e çmimit të kontratës.

13.4 Në qoftë se Kontraktuesi nuk ndërmerr masa për të korrigjuar defektet e evidentuara nga Menaxheri i Projektit brenda afatit të caktuar, Menaxheri i Projektit do t'i vlerësojë defektet ose do të angazhojë një person të tretë për t'i eliminuar defektet.

13.5 Autoriteti Kontraktues do të kërkojë nga kontraktuesi kompensim ose do të kalkulojë shumën e vlerësuar në çmimin përfundimtar të kontratës.

## **Neni 14 Paramasa dhe Paralogaria**

14.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përbajnë pagesë për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

14.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregojë shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

## **Neni 15 Vërtetimet e pagesës**

15.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar në parë.

15.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

15.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

15.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Paralogarisë, vlera e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

15.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

## **Neni 16 Pagesa**

16.1 Pagesat do të bëhen në **Euro**.

16.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do t'i paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data e të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

16.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

16.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

## **Neni 17 Shkaqet për kompensim**

17.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

17.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

## **Neni 18 Tatimi**

18.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

18.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

18.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

18.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

#### **Neni 19 Dëmet e likuiduara**

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

#### **Neni 20 Parapagimi**

20.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënë e Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë dhe nga një bankë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

20.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënë është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

20.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përmëryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

#### **Neni 21 Mbajtja e Parasë**

21.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalohej nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shumë në asnjë rast nuk do të tejkaloj 10% e vlerës totale të kontratës origjinale.

21.2 Me lëshimin e Certifikatës mbi Përfundimin e Punëve nga ana e Menaxherit të Projektit, shuma totale e ndaluar do të paguhet Kontraktuesit kur të kalojë periudha garancuese e Defekteve dhe Menaxheri i Projektit ka vërtetuar se Defektet e njoftuara nga Menaxheri i Projektit Kontraktuesit para përfundimit të kësaj periudhe janë korrigjuar. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

#### **Neni 22 Siguria e ekzekutimit**

22.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

22.2 Sigurimi do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

22.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

#### **Neni 23 Kostoja e Riparimeve**

23.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mos të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

Titulli: GRANTI PERFORMANCËS 2023 LOT II: Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kallderm rreth lumit Moravë Viti: VI657-23-6765-5-1-1;  
Nr.b.VII/57-23-035-511

## **Neni 24 Përfundimet dhe Certifikata e pranimit të punëve**

24.1 Pasi që kryesisht të jene përfunduar të gjitha punët dhe të kenë kaluar të gjitha Testet e kompletimit të punëve të përshkruara në kontratë, kontraktuesi mund të njoftoj Menaxherin e Projektit me një njoftim me shkrim se do të kryej të gjitha punët e diskutueshme gjatë Periudhës Garantuese të defekteve. Ky njoftim dhe ky zotim se të gjitha punët e diskutueshme do të kompletohen gjatë Periudhës garantuese për defekte do të merren si kërkesë e Kontraktuesit për Menaxherin e Projektit për lëshim të Certifikatës-mbi-Pranim të punëve.

24.2 Brenda 21 ditëve të pranimit të kësaj kërkesë Menaxheri i Projektit ose do të lëshoj Certifikatën e pranimit të punëve, duke cekur datën, sipas mendimit të tij, e përfundimit të punëve ose do të jap instruksione për punët të cilat duhet të kryhen nga ana e Kontraktuesit para lëshimit të kësaj Certifikate.

24.3 Kontraktuesi, me pëlqimin e Menaxherit të Projektit, ka të drejtën e pranimit të kësaj Certifikate brenda 21 ditëve të kompletimit të punëve dhe të përmirësimit të defekteve të cekura.

24.4 Autoriteti Kontraktues do të marrë përsipër vend pranimin dhe punët brenda shtatë ditëve nga lëshimi i certifikatës së përfundimit nga Menaxheri i Projektit.

## **Neni 25 Llogaritja përfundimtare**

25.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit llogarinë e cila përfshin në detaje të gjitha punët të cilat duhen të paguhet Kontraktuesit sipas kontratës para përfundimit të Periudhës garantuese për defekte. Menaxheri i projektit do të lëshoj Certifikatën e periudhës garantuese të defekteve dhe do të certifikoj cilëndo pagesë finale e cila duhet të paguhet Kontraktuesit brenda 15 ditëve pas pranimit të llogarisë nga ana e kontraktuesit nëse nuk vëren të meta. Nëse llogaritja përfundimtare e kontraktuesit nuk është e plotë apo është e pa saktë, Menaxheri i Projektit brenda 15 ditësh do të paraqesë një plan që paraqet fuqihëqimin e korrigjimeve dhe shtesave që janë të nevojshme. Nëse llogaria përfundimtare edhe pas ri-dorëzimit akoma mbetet e pakënaqshme, Menaxheri i Projektit do të vendos mbi shumën e cila do të paguhet Kontraktuesit dhe do të lëshoj certifikatën mbi pagesën.

## **Neni 26 Shkëputja e kontratës**

26.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

26.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprejë punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

26.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 26.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

26.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundojë vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë.

Titulli: GRANTI PERFORMANCËS 2023 LOT II: Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kallderm rreth lumit Moravë Viti: VI657-23-6765-5-1-1;  
Nr.b.Vit: 57-23-035-511

Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

26.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

#### **Neni 27           Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

27.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shumat totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

27.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

#### **Neni 28           Prona**

28.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

#### **Neni 29           Lirimi nga Ekzekutimi**

29.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

#### **Neni 30           Forca madhore**

30.1 "**Force Madhore**" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

30.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejt që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezuluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.

Titulli: GRANTI PERFORMANCËS 2023 LOT II: Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kallderm rreth lumit Moravë Viti: VI657-23-6765-5-1-1;  
Nr.b.Viti 57-23-035-511

v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### Neni 31 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mendojnë ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### Neni 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- ose vendim nga gjyqi;
- kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

## PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënime kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amanda nentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse Gjykatës themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje ekonomike
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <i>[Gjuha Shqipe]</i>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	Shuma maksimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ;

Titulli: GRANTI PERFORMANCËS 2023 LOT II: Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kallderm rreth lumit Moravë Viti: VI657-23-6765-5-1-1;  
 Nr.b.VI(57-23-035-511

		(d) dëmtim personal ose vdekje: (e) Jane te parapara ne policen e sigurimeve te dorezura nga OE.
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda <b>Planit dinamik të dorëzuar ne ofertën e tenderit.</b>
Menaxheri i kontrates	8.2	Inxh.d. Liridon Jonuzi
Inspektimi dhe testimi	9.1	Menaxheri i projektit, udhëheq dhe mbikëqyrë me punimet e te realizohen sipas projektit dhe është përgjegjës të përcjell kualitetin dhe kërkon atestet e cilesisë sipas kontratës, dhe përcjell situacionet per pagese, s pas dinamikës së projektit dhe Planit të menaxhimit të kontrates.
Specifikimet		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kualiteti të jete konfrom standardeve, të përgjigjet ISO standardeve për kualitet</li> <li>• Garancioni i kualitetit të jetë 12+1 muaj pas pranimit teknik</li> <li>• Aestet duhet të sjellën për të gjitha materialet e kërkuara nga Mbikëqyrja</li> <li>• Testimi dhe marrja e kampioneve do të jete i përcaktuar nga mbikëqyrja</li> <li>• Dimensionet, sasia, trashësia dhe cilësia të jete konfrom paramasës së tenderit</li> <li>• Të vendoset panoja me shënime për punekryesin dhe investitorin ne dimension prej min.120x150 cm</li> </ul>
	10.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë sipas <b>Planit Dinamik, dhe kushteve ne Planin e menaxhimit të kontrates</b> Puna fillon ne ditën e nënshkrimit dhe përfundon me datë 31.12.2024
Pagesat		Pagesat bëhen sipas pranimit të situacioneve mbi punet e kryera dhe pranimit të Raportit nga Mbikëqyrja gjegj. Menaxheri i kontrates.
Shkaqet për kompensim	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [ 3 ] ditë pas marrjes së fteses urdhit nga AK
	19.1	Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë/realizoj ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, punëdhënësi, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do

Titulli: GRANTI PERFORMANCËS 2023 LOT II: Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kallderm rreth lumit Moravë Viti: V1657-23-6765-5-1-1;  
Nr. b V1657-23-035-511

Dëmet e likuiduara		të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet shadimit të periudhës së kontratës dhe datës af tualt të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me <b>[0,05%]</b> në ditë, ose [5/100] të vlerës së punëve të pa dorëzuara/realizuar deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është e Çmimit final të Kontratës.
Dëmet	20.1	Infrastruktura ekzistuese nuk guxon te demtohet, ne rast se po, duhet te kthehet ne gjendjen e meparshme
Mbajtja e Parasë	21.1	
Siguria e ekzekutimit	22.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <b>10 %</b> e vlerës së kontratës ose ne shumen prej <b>27,777.70</b>
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <i>[shëno përqindjen]</i> .
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	Palet do te bejne te gjitha perpjekjet per te zgjidhur ne menyre miqsore te gjitha mosmarveshjet qe mund te ndodhin ne mes tyre sapo te shfaqet ndonje mosmarveshje , palet do te lajmrojne njeratjetrer me shkrim per poziten e tyre ne mosmarveshje dhe per ndonje zgjidhje qe ata konsiderojne se eshte e mundhme
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet nd'yshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatës themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje ekonomike</b> në pajtim me ligjin në Kosovë.

## GRANTI PERFORMANCËS 2023

LOT II: PARAMASA E PARALLOGARIA E PUNIMEVE DHE MATERIALEVE PËR :  
"RREGULLIMI I RRUGËS DHE TROTUARIT ME KALLDERM"

Nr	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera totale
I	<b>Punët përgaditore</b>				
1	Matjet gjeodezike dhe piketimi ne baze te projektit.	m'	540.00	1.20 €	648.00 €
2	Gryerja e asfaltit ekzistues ne thellësi deri 3.0 cm. Materiali i gryer të deponohet në vendin ku e cakton organi mbikqyrës. (min 5km nga vendpunishtja).	m <sup>2</sup>	3005.00	1.20 €	3,606.00 €
3	Demolimi i kubëzave ekzistuese në trotuare .Kubëzat të deponohen në vendin ku e cakton organi mbikqyrës. (min 5km nga vendpunishtja).	m <sup>2</sup>	810.00	10.00 €	8,100.00 €
4	Demolimi i skajorëve ekzistuese në mes të rrugës dhe trotuareve .Skajorët të deponohen në vendin ku e cakton organi mbikqyrës. (min 5km nga vendpunishtja).	m'	540.00	10.00 €	5,400.00 €
5	Demolimi dhe thyerja e disa pjesëve të betonit nëpër vende të caktuara ku kemi zgjerim të trotuarit dhe trases së rrugës	m <sup>3</sup>	5.00	120.00 €	600.00 €
6	Çvendosja e shtyllave të larta të ndriçimit ekzistues, duke pasur për bazë edhe demolimin e bazamentit , tokëzimit dhe të gjitha pjesëve tjera përcjellëse	copë	20.00	350.00 €	7,000.00 €
7	Ngritja e pusetave ekzistuese dhe nivelizimi me beton.	copë	12.00	50.00 €	600.00 €
			<b>Shuma totale 1:</b>		<b>25,954.00 €</b>
II	<b>Punët në trupin e rrugës</b>				
1	Furnizimi mbushja dhe shtrirja e trupit të rrugës me zhavor gur i thyer 0-31,5 mm me ngjeshje 60 MN/m <sup>2</sup> , t=15.0 cm.	m <sup>3</sup>	450.75	10.00 €	4,507.50 €

2	Furnizimi mbushja dhe shtrirja e trotuarit në anën e djathtë të rrugës nga rrethrotullimit te gjamia në drejtim të rrugës te shkollat e mesme me zhavor gur i thyer 0-31,5 mm me ngjeshje 60 MN/m <sup>2</sup> , t=20.0 cm.	m <sup>3</sup>	162.00	10.00 €	1,620.00 €
3	Furnizimi dhe vendosja e kinetave nga betoni në pjesën e majtë të rrugës ,të cilat shërbejnë për grumbullimin e ujërave atmosferike.	m'	540	55.00 €	29,700.00 €
4	Montimi I gypave nga Polieteleni SN 8 , Ø 200 mm nga pjesa e rruges deri në lumin Morava për largimin e ujërave atmosferike. Të parashifet edhe përpunimi I hyrjeve dhe daljes se gypave me beton nga ujëmbledhësit .	m	80.00	8.00 €	640.00 €
6	Furnizimi , dhe ndertimi i ujëmbledhesit me dimenzion 60x60 nga betonarme sipas standardeve per largimin e ujrave atmosferike ne kanal in anesor (vetëm në anën ka është ndërtuar trotuari) në thellësi 0.50-0.80 m ne qdo 50 m (për gjatesin prej 540 m)	cope	11.00	120.00 €	1,320.00 €
7	Dislokimin e shtyllave ekzistuese dhe zevendesimin e tyre me shtylla te betonit me lartesi H=9m kendore tip 40° , me bazament te betonit duke perfshire germimin per bazament me dimensione (1.0x1.0x1.5)m, vendosjen e betonit , shiritin e tokezimit Fe/Zn 25x4mm (3.5m), reren e imet , montimi i unazes , vendosja e konzolles (per rrjet ajror 0.4kV) , trupave ndricues (nese ekzsiton) si dhe demontimi dhe montimi i serishem i kablllove ekzistuese ajrore dhe nentokesore eventuale dhe materiali tjetër i nevojshem komplet me ateste per nje shtylle te dislokuar.	copë	3.00	550.00 €	1,650.00 €


8	Furnizimi dhe vendosja e shtyllave me shtylla metalike me lartësi H=4.50m (Të cilat kanë trupin e ndrikuar me LED sipas projektit), me bazament të betonit duke përfshirë germimin për bazament me dimensione (0.50x0.50x0.75)m, vendosjen e betonit, shiritin e tokëzimit Fe/Zn 25x4mm (3.5m), reren e imet, montimi i unazës, vendosja e konzollës (për rrjet ajror 0.4kV), trupave ndricues eficient të tipit LED si dhe montimi i kabllave ajrore dhe nentokesore eventuale dhe materiali tjetër i nevojshëm komplet me ateste për një shtyllë të vendosur	copë	26.00	350.00 €	9,100.00 €
9	Furnizimi, planifikimi dhe vendosja e gurëve me trashësi 10 cm me dimensione 10x10 në formë kubike (të ashtuquajtura "KALLDËRM") me ngjyrë hiri të qelur dhe të mbyllur (sipas projektit). Rruga e kalldërmit në gjendje të ngjeshur të ketë fortësi deri në 60 N/mm <sup>2</sup> . (Për vendosjen e kalldërmit të parashifen edhe shtresat e nevojshme të zhavorit dhe rërës) Te sillen atestet	m <sup>2</sup>	3,774.00	49.00 €	184,926.00 €
10	Mbjellja e drunjeve dekorativ në çdo 20 m largësi (të cilat duhet të jenë min 3.0 m lartësi, formën dhe llojin e zgjedh investitori) në tërë gjatësinë e trotuarit (540 m)	cope	50.00	50.00 €	2,500.00 €
11	Furnizimi, transporti dhe montimi i ulëseve për kembesoret në çdo 50m sipas detalit	cope	20.00	200.00 €	4,000.00 €
12	Furnizimi, transporti, montimi i shportave në çdo 50 m me mbajteset e tyre nga materiali i llamarinës dhe i ngjyrosur sipas detalit	cope	20.00	50.00 €	1,000.00 €
13	Transporti, montimi i skajoreve 18x24 cm C-25/30 Skaj anës së mbrendshme të rrugës dhe betonimi i tyre.	m	530.00	12.00 €	6,360.00 €

14	<p>Furnizimi, transporti dhe vendosja-instalimi i pengesave/shtyllave lëvizëse/teleskopike për pjesët ku lejohet qasja e kufizuar e automjeteve .Pengesë lëvizëse janë në formë shtyllë nga prodhuesi me origjinë nga EU (sipas detajit të dhënë). Pengesa është e punuar prej inox-i ø154mm ose ø159mm çeliku të galvanizuar dhe çeliku të mveshur me pluhur poliestër, të paisur me një sistem me lëvizje pistoni me gaz e cila lejon pengesën të jetë e fshehur nën nivelin e tokës me presion prej një 15-20kg. Sigurimi i lëvizjes së pengesave bëhet me sistem të mbylljes që bllokton pistonin.Kutia e mekanizmit dhe pengesat e fshehura janë të punuara prej nga fletëzave të trasha çeliku 3 dhe 5 mm, ndërsa të mbulesa e dukshme është e punuar prej çeliku i galvanizuar dhe fleta çeliku të mveshura me pluhur poliestër veshura. Të gjitha pajisje shtesë janë çelik inox. Dimensionet e pengesave janë 422x332mm, me lartësi 827mm.Pengesat ngriten 500mm mbi nivelin e tokës.Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te</p>	cope	18.00	250.00 €	4,500.00 €
				<b>ÇMIMI TOTAL :</b>	<b>251,823.50 €</b>

<b>L. II</b>	<b>REKAPITULLIMI I TOTAL</b>	
1	PUNËT PËRGADITORE	
2	PUNËT NË TRUPIN E RRUGËS	25,954.00 €
		251,823.50 €
		<b>SHUMA TOTALE "II":</b> 277,777.50 €

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	" KUSHTRIMI NM " SH.P.K & " BURIMI E " SH.P.K
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TE C	Naser Misini
NËNSHKRIMI:	
DATA:	17.08.2023
VULA:	

Verifikoi:

1. 
2. 
3. 



# Lloji i Garancisë: Garanci Kontrate

Për

Seria | 10000547049

KUVENDI KOMUNAL VITI

(Emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

**DUKE PASUR PARASYSH QË**

Kushtrimi NM SH.P.K

(Emri i operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik")

ka marrë përsipër të lëshoj një sigurim të realizimit lidhur me kontratën me titull

LOT II Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kalldorin rreth lumit Moravë Vdi,

të dhënë me numrin e Prokurimit

657-23-6765-6-1-1

(Nr. i referencës së prokurimit)

për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues;

**DHE DUKE PASUR PARASYSH QË** Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;

**DHE DUKE PASUR PARASYSH QË** jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci;

**PËR KËTO ARSYE** vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej

27,777.75 €

Njëzet e Shtatë Mijë e Shtatë Qind e Shtatëdhjetë e Shtatë Euro e Shtatëdhjetë e Pesë Cent

(shuma e garancisë në numra dhe në fjalë)

dhe ne marrim përsipër të ju pagujmë, me kërkesën tuaj të parë me shkrim që deklarohen që Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse:

- Autoriteti kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik për të kryer obligimet e votë sipas kontratës; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo shkakton dëm të konsiderueshëm të Autoriteti kontraktues dhe/ose kërkon nga Autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të konsiderueshme për realizimin e kësaj kontrate; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo ka lënë pa pagesë shumë punëtorë, nënkontraktues, dhe/ose furnizues material; ose
- Oferatë jonormalisht e ulët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik zbulon që kjo ofertë nuk mund të realizohet dhe pa asnjë ankesë ose argument, të gjitha shumat brenda limiteve të

27,777.75 €

(shuma e garancisë)

sig është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepin arsyet ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës

Lëshuar në

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit

28.09.2023

ditë më

31.01.2025

Prishtinë

datë

28.09.2023

PRISHTINË



29.09.2023

02-370/01-1189



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Komuna e Vitisë**  
**Opstina Vitina-Municipality of Vitina**



ZYRA E KRYETARIT

KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr 03/L-040 (Gazeta zyrtare nr 28/2008) dhe nenit 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë 02 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

## V E N D I M

**PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT PËR MBIKËQYRJEN E PUNIMEVE SIPAS KONTRATËS:** Titulli i kontratës : GRANTI PERFORMANCËS 2023, LOT II: Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kallderm rreth lumit Moravë Viti.Nr.pr.657-23-6765-5-1-1, Nr.Brendsh VI657-23-035-511

### I.

**Liridon Jonuzi**, CAKTOHET menaxher i projektit për kontratës: Titulli i kontratës : GRANTI PERFORMANCËS 2023, LOT II: Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kallderm rreth lumit Moravë Viti.Nr.pr.657-23-6765-5-1-1. Mbikëqyrës i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës emërohet: Arta Ajeti

### I.

Menaxheri nga neni 1 i këtij vendimi ka për detyrë që të bëjë:

- Menaxhimin e punimeve të projektit, të menaxhoj, implementoj dhe administroj obligimet sipas kontratës dhe të siguroj se OE kryen projektin në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara, të kontratës, bazuar në normativat ligjore në fuqi.
- Të siguroj kontroll të kostove, cilësisë dhe sasisë dhe kohën e dërgesave (vonesave).
- Të siguroj arttijen e qëllimit të kontratës, fushëveprimit, specifikacionit dhe përgjegjësit e AK, që ka detyrim punëkryesi sipas kontratës dhe të raportoj tek Mbikëqyrësi i dpd
- Të dorëzoi Planin e menaxhimit të kontratës dhe mbikëqyr kontratën nga nënshkrimi deri në skadimin e saj, kryerjen e pagesave dhe pranimin final të projektit.
- Të mbikëqyr/pranoj punët e kryera nga OE.

### III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, për detyrimet dhe përgjegjësit e menaxherit nga neni 1 i këtij vendimi,

### IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Menaxherit,
2. Operatorit,
3. Zyrës së Prokurimit,
4. Arkivit

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË  
Sekol HALITI

